

**STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ING2 PROGETTI”,SH.P.K.**

Ne Lezhe sot me datën **04.07.2022** ne mbështetje te Ligjit Nr. **9901**, date **14.04.2008** “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,”Statuti” te Ligjit nr.7580 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”.ligji nr.9723 date **03.05.2007** “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” .

I. Eduart Ndocaj, atesia Mark, I datelindjes 18.09.1975, lindur ne Lezhe dhe banues ne Manati, Bashkia Lezhe, gjendje civile I martuar, I pajisur me pasaportë nr. DB1159514 , nr. Personal **H50918183I**, Nr. personal 0039 339 338 9412 , email eduardndocaj@gmail.com

Me vullnetin e lire dhe te plote me cilesine e ortakeve vendosen :
Themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te “**ING2 PROGETTI**”, **SH.P.K.** duke përcaktuar të drejta dhe detyrime në kete status si me poshtë :

**KAPITULLI I
FORMA ,EMERTIMI OBJEKTI SELIA ,KOHEZGJATJA**

Neni 1

Shoqëria “**ING2 PROGETTI**”, **SH.P.K.** në vijim Shoqëria , krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
Shoqëria vepron sipas ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, ligjit Nr.7850 date 29.07.1994 “Per Kodin Civil te Republikës së Shqipërisë“ si dhe gjithë legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Statuti eshte në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2

EMËRTIMI

Emërtimi i Shoqërisë është “**ING2 PROGETTI**”, **SH.P.K.** Shoqëria ka vulen dhe logon e saj identifikuese, ne formen dhe me ekstremitetet e caktuar nga asambleja e ortakeve i te shoqerise .

Neni 3

OBJEKTI I SHOQËRISË

Objekt i veprimtarise se shoqerise “**ING2 PROGETTI**”, **SH.P.K.** eshte ne perputhje me legjislacionin tregetar aktual Shqiptar dhe do te jete:

Prodhim i energjise diellore, energjise termale te rinovueshme.

Servis , projektme, konstruksione ingjinerike .

Ndertime civile industriale te cdo lloji. Restaurime dhe tregtime te objekteve Civile-Industriale- Turistike.

Ndertim rrugesht te te gjitha kategorive, te veprave arti, te ujrave, ujesjellesa, kanalizime etj.

Import- Eksport e transport te sistemeve dhe materialeve per ngrohje dhe ftohje nepermjet energjise diellore, energjise termale.

Import- Eksport me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial, ushqimore, konfeksione, elektro shtepiake etj. Hapje e agjensive turistike per sherbime te ndryshme turistike udhetimi, organizimi i guidave turistike brenda dhe jashte territorit te Republikës së Shqipërisë.

Marrja dhe dhenia me qera apo shitja-blerja e pasurive te paluajtshme dhe te lujtshme si dhe te gjitha llojet e tjera te mjeteve motorike te cdo lloj tipi te automjeteve te transportit brenda dhe jashte territorit te Republikës së Shqipërisë



Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve.

Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.

Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në Shqipëri ose jashtë saj. Si dhe edo aktivite qe e lejon legjislacioni Shqiptare.

Neni 4

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Kohezgjatja e Shoqërisë “ING2 PROGETTI”, SH.P.K. është e pakufizuar dhe fillon në momentin e Regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit sipas ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 nenet 26, 28, 32 dhe 35 të tij, pershtatur me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.

Shoqëria me pergjegjesi te kufizuar “ING2 PROGETTI”, SH.P.K. prishet:

Me vendim të asamblese se pergjithshme .

Me hapjen e procedurave te falimentimit .

Nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit Nr. 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.

Me vendim te gjykates.

Per arsye te tjera te parashikuara ne status.

Neni 5

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqërisë është në adresen: Lezhe, Lagjia Beslidhja, Rruga Shtraus, ZK .8632, kati perdhe, në pasurinë me nr.4/191-N14

Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë si edhe jashtë saj.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT

Neni 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë “ING2 PROGETTI”, SH.P.K. është 100.000 leke.


Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë do të jetë ne para është në përputhje me kontributet e tij të mëposhtme:

1. Eduart Ndocaj, atesia Mark, I datelindjes 18.09.1975, lindur ne Lezhe dhe banues ne Manati, Bashkia Lezhe, gjendje civile I martuar, I pajisur me pasaportë nr. DB1159514 , nr. Personal H50918183I, Nr. personal 0039 339 338 9412 , email eduartndocaj@gmail.com, mbajtes i 100% te kuotave te kapitalit te Shoqerise

Neni 7

KËRKESA PËR TË PAGUAR KUOTAT DHE TËRHEQJA E KUOTAVE TË PAPAGUARA

Administratorët mund t’u kërkojnë ortakëve të shoqërisë nese ka pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi



të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

Zotëruesit e përbashkët të një kuote nese ka do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratorët mund të njoftojnë paraprakisht të paktën katërbëdhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumat e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast moszbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.

Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.

Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyeshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

Neni 8

LLOJET E KUOTAVE, TË DREJTAVE DHE KUFIZIMEVE

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emtohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e Nenit 87 të Ligjit 9901.

Neni 9

CERTIFIKATAT E KUOTAVE

Secili ortak nese ka, ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 10

MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar janë lirisht të transferueshme të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë; b) shitblerjes; c) trashëgimisë; ç) dhurimit; d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.


2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

Neni 11:

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

1. Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë. Kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.



2. Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Neni 12:

BLERJA E KUOTAVE TË VETA

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërndahen ortakëve apo emetimi i kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimeve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuar nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Per tregtaret dhe shoqëritet tregtare".

KREU III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 13:


THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas Nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet te gjithë ortakëve, jo me vonë se 7-dite përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese. Secilit ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 14

MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*onference call*), audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
2. Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
3. Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej Administratorëve nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
4. Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
5. Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
6. Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga: Kryetari; ose 2. një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.



Ortaku i vetem ka te drejten qe i njihet nga ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" apo statuti i shoqerise, per te marre unanimisht cdo vendim, me kusht qe kjo marveshje te behet me shkrim.

Neni 19

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per :
Vleresimin e veprimtarise se tij .

Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij.

Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria.

Dhënien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku te cilin perfaqeson.

Neni 20

PROCESVERBALI I MBLEDHJES SE ASAMBLESE

Vendimet e asamblese se pergjitheshme duhet te rregjistrohen ne proces verbal. Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te proces verbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme.

Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesmaresve, si edhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit .

Neni 21

HETIMET E POSAÇME

Personi ose personat qe plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës sipas nenit 91 të Ligjit paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

ADMINISTRATORËT

Neni 22

EMËRIMI I ADMINISTRATORËVE DHE I DREJTUESIT TEKNIK

1.Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2.Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3.Administrator I Shoqerise "ING2 PROGETTI" SH.P.K emërohet :

Z. Eduart Ndocaj, atesia Mark, I datelindjes 18.09.1975, lindur ne Lezhe dhe banues ne Manati, Bashkia Lezhe, gjendje civile I martuar, I pajisur me pasaportë nr. DB1159514 , nr. Personal H50918183I, Nr. personal 0039 339 338 9412 , email eduartndocaj@gmail.com, me afat 5-vjecar me të drejtë përsëritje.

Neni 23

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORËVE


Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

Te kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë,duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme.

Te përfaqësojnë shoqërinë tregtare.

Te kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë.

Te përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim



Te krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë.

Te kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Te raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Te kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligji dhe në statut

Administratoret janë të detyruar të theksin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur: sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. -shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar. -shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e adminis marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kreu V

DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Neni 24

DIVIDENDËT

Pas plotësimit të parashikimeve të Nenit 77 të Ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguar për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhet në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguar për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë.

Neni 25

KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit 9901, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e paspërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

KREU VI


PRISHJA DHE NJOFTIMET

Neni 26

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

1. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj.
2. Me vendim të asamblesë së përgjithshme.
3. Me hapjen e procedurave të falimentimit.



4. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".
5. Me vendim të gjykatës
6. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901.
- Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

Neni 27

RREGJISTRIMI I SHPERBERJES

Administratoret rregjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendres Kombetare te Rregjistrimit ne perputhje me ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit", neni 43.

Nese prishja e shoqërisë behet me vendim gjykate, gjykata ne perputhje me ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit", neni 45, ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Rregjistrimit per rregjistrim.

Neni 28

LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESHME

Secili nga ortakët mund të largohet nga shoqëria në çdo moment duke mos patur asnjë lloj pengese nga ortakët e tjerë për motive personale apo nëq shoqëria ka kryer veprime në dem të tij, apo nëse është penguar të ushtroje të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të pa arsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë.

Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtrijë shkaqet e largimit. Administratori duhet të therrase mbledhjen e asamblese së përgjithëshme menjëherë pasi të ketë marrë dijeni për njoftimin e largimit, sipas parashikimeve të nenit 26.2 të statutit, për të vendosur që ortakut të likuidohet kuota e tij, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme. Në këto raste nuk duhet të ketë asnjë lloj pengese nga ortakët.

Neni 29

PERJASHTIMI I ORTAKUT

Asambleja e përgjithëshme në bazë të një vendimi të zakonshëm mund të kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut nëse shoqëria është me disa ortakë, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Do të konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut:

Me dashje apo me pakujdesi të rende i shkakton dëm shoqërisë ose ortakëve të tjerë.

Me dashje apo me pakujdesi të rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj.

Perfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e mardhenieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut, ose

Me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë

Neni 30

EKSPERTI KONTABËL I AUTORIZUAR

Eksperti Kontabel i Autorizuar emrohet nga Asambleja e Përgjithëshme ose me Vendim Gjykate për kontrollin e bilanceve, librave kontabël të Shoqërisë etj.

Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet në çdo moment sipas mënyrave të parashikuara nga legjislati në fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 31

VITI FINANCIAR DHE BILANCI VJETOR

Ushtrimi financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombetare të Rregjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe nese jane te nevojshme te ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme.
Miratimi i dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te behet brenda 6 (gjashte) muajve qe nga fundi i vitit financiar.

Neni 32

FITIMET

Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor, duke zbritur 5% (pesë për qind) qe caktohen për rezervën ligjore deri në 10% (dhjetë për qind) e kapitalit themeltar, dhe duke zbritur gjithashtu të gjitha shumat që Asambleja e Pergjithshme vendos t'i vëre ne dispozicion te shoqerise, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara respektivisht.
Asambleja e Pergjithshme mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

Neni 33

NJOFTIMET

1. Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

2. Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakut. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.

3. Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

Neni 34

LIKUIDIMI

Në rast prishje, Shoqëria do të likuidohet. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Pergjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Pergjithshme do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi vlefshmerinë e punës së kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit. Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakut apo ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 35

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Per ceshjet qe nuk parashikohen ne kete statut zbatohen dispozitat e ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Ky statut eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne ne dy gjuhe shqipe dhe italiane pasi iu lexua ortakët e shoqerise, dhe u pranua vullnetarisht nenshkruhet prej tyre.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE.ADMINISTRATORI



AKT- THEMELIMI
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ING2 PROGETTI", SH.P.K.

Neni 1
THEMELUESIT E SHOQERISE

1. Ortaku themelues

1. Eduart Ndocaj, atesia Mark,

I datelindjes 18.09.1975, lindur ne Lezhe dhe banues ne Manati, Bashkia
Lezhe, gjendje civile I martuar, I pajisur me pasaportë nr. DB1159514 , nr. Personal H509181831, Nr.
personal 0039 339 338 9412 , email eduardndocaj@gmail.com, mbajtes i 100% te kuotave te kapitalit te
Shoqerise

Sot me daten 04.07.2022 , kame vendosur themelimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ING2
PROGETTI", SH.P.K. ne perputhje me ligjin 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"
duke firmosur kete akt themelimi.

Neni 2
EMERTIM ,FORMA DHE SELIA E SHOQERISE

Emri i shoqerise do te jete "ING2 PROGETTI" SH.P.K Forma e shoqerise do te jete shpk
Adresa e saj zyrtare eshte Lezhe, Lagjia Beslidhja, Rruga Shtraus, ZK .8632, kati perdhe, në pasurinë me
nr.4/191-N14

Shoqeria do te ushroje aktivitetin e saj ne rrethin e Lezhes.
Ajo mund te krijojë dhe te mbyllë ne Shqipëri ose jashtë saj , perfaqesi apo seli të tjera.


Neni 3
KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e aktiviteti te shoqerise eshte e pakufizuar. Si date e fillimit te aktivitetit te saj do te jete data e
regjistrimit ne QKB Lezhe. Aksioneret me vendim te asamblese se pergjithshme kane te drejte ta zgjasin
ose ta shkurtojne kete afat.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRITARISE

Objekt i veprimtarise se shoqerise " ING2 PROGETTI", SH.P.K. është në përputhje me legjislacionin
tregëtar aktual Shqiptar dhe do te jete:
*Prodhim i energjise diellore, energjise termale te rinovueshme.
Servis , projektme, konstruksione ingjinerike .
Ndertime civile industriale te cdo lloji. Restaurime dhe tregtime te objekteve Civile-Industriale- Turistike.
Ndertim rruges te te gjitha kategorive, te veprave arti, te ujrave, ujesjellesa, kanalizime etj.
Import- Eksport e transport te sistemeve dhe materialeve per ngrohje dhe ftohje nepermjet energjise diellore,
energjise termale.
Import- Eksport me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industrial, ushqimore, konfeksione, elektro
shtepiake etj. Hapje e agjensive turistike per sherbime te ndryshme turistike udhetimi, organizimi i guidave
turistike brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
Marrja dhe dhenia me qera apo shitja-blerja e pasurive te paluajtshme dhe te lujtshme si dhe te gjitha llojet
e tjera te mjeteve motorike te cdo lloj tipi te automjeteve te transportit brenda dhe jashte territorit te
Republikes se Shqiperise*

Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose shtohet me vendim të Asmablesë së Përgjithshme të
Ortakeve.
Shoqëria mund të ushtrojë veprimtari të tjera plotësuese që janë të dobishme ose të nevojshme për realizimin
e objektit të saj, në përputhje me ligjin shqiptar.
Shoqëria do të bashkëpunojë me persona të tjerë fizikë ose juridikë që ushtrojnë të njëjtën veprimtari në
Shqipëri ose jashtë saj. Si dhe cdo aktivite qe e lejon legjislacioni Shqiptare .



**NENI 5
KAPITALI THEMELOR**

Kapitali i shoqerise "ING2 PROGETTI" SH.P.K do të jetë 100.000 lekë i ndarë në 1 kuote. Themeluesi ka të drejtë të zmadhojë ose të zvoglojë kapitalin e shoqerise në natyrë dhe në para në përputhje me statusin e shoqerise. Kapitali themelore i shoqerise i ndarë në kuota në para është nënshkruar nga themeluesi si më poshtë

1. Ortaku themelues Z. Eduart Ndocaj, mbajtes i 100 % të kuotave të kapitalit themelor

**NENI 6
ORGANET E SHOQERISE**

Shoqeria drejtohet organizohet dhe administrohet nga organet e sajë që janë Asambleja e Përgjithshme me një administrator.

**Neni 7
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

Asambleja e Përgjithshme është organi vendimorë i shoqerise dhe merr vendime me të rëndësishme për ecurinë e shoqerise. Asambleja e Përgjithshme përbehet nga ortakët e shoqerise.

**Neni 8
ADMINISTRATORI**

Shoqeria do të administrohet dhe përfaqësohet nga një administrator i cili do të përbehet nga një antare që do të emrohet nga asambleja e përgjithshme për një periudhë 5 vjeçare. Statusi i shoqerise përfaqton kompetencat e administratorit.

**Neni 9
VITI FINANCIAR**

Viti i parë financiar do të fillojë me rregjistrimin e shoqerise në rregjistrin Tregëtarë të QKB .

**Neni 10
MOSMARRVESHJET**

Për çdo mosmarrvëshje e lindur në kuadrin ose për shkak të kesajë kontratë çështja i paraqitet Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Lezhë duke gjykuar mbi bazën e ligjeve shqiptare.

**Neni 11
SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR PRISHET**

Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
Me vendim të asamblese së përgjithëshme .
Me hapjen e procedurave të falimentimit.
Nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtarë për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarsë në përputhje me me ligjin Nr.9723 datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit ", neni 43, pika 3.
Me Vendim të Gjykatës .
Për arsye të tjera të parashikuara në statut.

**Neni 12
DISPOZITA E FUNDIT**

Te gjitha shpenzimet që do të kryhen deri në rregjistrimin e shoqerise si person juridik do të përfaqshihen në bilancin ekonomik të shoqerise.
Ky akte themelim përbehet nga 12 nene. Ai është përgaditur në 4 kopje në gjuhën shqipe.
Ky akte themelimi u shkrua ,u lexua u firmos me vullnetin e lire e të plote nga ortakët themelues të shoqerisë , në datën e sotme .

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE.ADMINISTRATORI

